

**VENDIM****Nr. 383, datë 29.6.2023****PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT
“STANDARDET SHTETËRORE PËR
SPECIFIKIMET TEKNIKE TË
INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR
NË SHQIPËRI – TEMA: SHËNDETI I
NJERËZVE DHE SIGURIA E TIJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 2, shkronja “n”, e 16, pika 1, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – Tema: Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



STANDARDET SHETETËRORE PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË
INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR NË SHQIPËRI.
TEMA: "SHËNDETI I NJERËZVE DHE SIGURIA E TIJ"

PËRMBAJTJA

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

2. HYRJE

- 2.1. Qëllimi
- 2.2. Si lexohet dokumenti.
- 2.3. Detyrimet ligjore
- 2.4. Fusha e veprimit

3. TEMA

- 3.1. Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij
 - 3.1.1. Parathënie
- 3.2. Përshkrimi i nëntemës "Shëndeti i njerëzve"
 - 3.2.1. Parathënie
 - 3.2.2. Skemat e aplikimit dhe diagrama UML për nëntemën "Shëndeti i njerëzve"
 - 3.2.2.1. Të dhënat statistikore shëndetësore, bazë
 - 3.2.2.2. Të dhënat statistikore shëndetësore, të përgjithshme
 - 3.2.2.3. Diagrama e përcaktuesit shëndetësor mjedisor
 - 3.2.3. Katalogu i tipologjive
 - 3.2.3.1. Indikatorët biologjikë
 - 3.2.3.2. Llojet e grupmoshave
 - 3.2.3.3. Lloji i indikatorëve biologjikë
 - 3.2.3.4. Llojet e parametrave statistikor të indikatorëve biologjikë
 - 3.2.3.5. Masa e determinantëve shëndetësor mjedisor
 - 3.2.3.6. Matja e zhurmës
 - 3.2.3.7. Matja e sëmundshmërisë
 - 3.2.3.8. Metadatat tematike të indikatorëve biologjikë
 - 3.2.3.9. Moshë
 - 3.2.3.10. Njësia e masës për përqendrim
 - 3.2.3.11. Njësia matëse e zhurmës
 - 3.2.3.12. Periudha referencë
 - 3.2.3.13. Përqendrimi
 - 3.2.3.14. Sëmundjet
 - 3.2.3.15. Statistikat e përgjithshme shëndetësore
 - 3.2.3.16. Statistikat e shërbimit shëndetësor
 - 3.2.3.17. Të dhënat statistikore të determinantëve shëndetësorë mjedisorë
 - 3.2.3.18. Të dhënat statistikore shëndetësore
 - 3.2.3.19. Vlera e llojit të parametrave të cilësisë së ajrit



- 3.2.3.20. Vlerat kimike
 - 3.2.3.21. Vlerat e llojeve të parametrave shëndetësorë mjedisorë
 - 3.2.3.22. Vlerat e llojit të masës së sëmundjes
 - 3.2.3.23. Vlerat e llojit të determinantëve shëndetësorë mjedisorë
 - 3.2.3.24. Vlerat e llojit të parametrave të vlerësimit të cilësisë së ujërave nëntokësorë
 - 3.2.3.25. Vlerat e llojit të shërbimit shëndetësor
 - 3.2.3.26. Vlerat e parametrave të vlerësimit të cilësisë së ujit të liqenit
 - 3.2.3.27. Vlera matrix
 - 3.2.3.28. Vlerat e llojit të medias
 - 3.2.3.29. Vlerat e llojit të burimit të zhurmës
 - 3.2.3.30. Vlerat e llojit të parametrave të cilësisë së ujit të lumit
 - 3.2.3.31. Vlerat e metodës së grumbullimit statistikor
 - 3.2.3.32. Vlerat e klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve
 - 3.2.3.33. Vlerat e shkaqeve të vdekjes
 - 3.2.3.34. Vlerat e llojit të shëndetit të përgjithshëm
 - 3.2.3.35. Vlerat e llojit të parametrave të cilësisë së ujërave për larje
- 3.3. Përshkrimi i nëntemës “Siguria”
- 3.3.1. Parathënie
 - 3.3.1.1. Të dhënat statistikore të sigurisë, bazë
 - 3.3.1.2. Të dhënat statistikore të sigurisë, shtesë
 - 3.3.2. Katalogu i tipologjive
 - 3.3.2.1. Informacionet e ngjarjes
 - 3.3.2.2. Lloji i njësisë së vendndodhjes
 - 3.3.2.3. Lloji i vendndodhjes së zjarrit ose shpërthimit
 - 3.3.2.4. Ngjarje
 - 3.3.2.5. Ngjarja e lidhur me rreziqet natyrore
 - 3.3.2.6. Ngjarja e lidhur me zjarrin ose eksplozimin
 - 3.3.2.7. Ngjarja e shkaktuar nga materiale të rrezikshme
 - 3.3.2.8. Ngjarjet e lidhura me trafikun
 - 3.3.2.9. Pasojat e ngjarjes
 - 3.3.2.10. Vlerat e llojeve të pasojave
 - 3.3.2.11. Vlerat e përdorimit të ndërtesave
 - 3.3.2.12. Vlerat e llojit të zjarrit ose shpërthimit
 - 3.3.2.13. Vlerat e llojit të materialeve të rrezikshme
 - 3.3.2.14. Vlerat e llojit të trafikut
- 3.4. Metadata
- 3.5. Kodi EPSG për KRGJSH-në
- 3.6. Cilësia e të dhënave
- 3.6.1. Saktësia pozicionale – Saktësia absolute ose e jashtme (Positional accuracy – Absolute or external accuracy)
 - 3.6.2. Saktësia tematike – Saktësia sasiore e atributëve (Thematic accuracy – Quantitative attribute accuracy)
 - 3.6.3. Cilësia kohore – Vlefshmëria kohore (Temporal quality – Temporal validity)
4. ANEKSE
- 4.1. Aneksi A – Katalogu i tipologjive
 - 4.2. ANEKSI C - Kodlistat
 - 4.2.1. Skema e aplikimit për nëntemën “Shëndeti i njerëzve”
 - 4.2.1.1. Vlerat e llojit të barrës së sëmundshmërisë



- 4.2.1.2. Vlerat e llojit të determinantëve shëndetësorë mjedisorë
- 4.2.1.3. Vlerat e llojit të shëndetit të përgjithshëm
- 4.2.1.4. Vlerat e llojit të shërbimit shëndetësor
- 4.2.1.5. Vlerat e llojit të medias
- 4.2.1.6. Vlerat e metodave të grumbullimit statistikor
- 4.2.1.7. Skema e aplikimit për nëntemën “Siguria”
- 4.2.1.8. Vlerat e përdorimit të ndërtesave
- 4.2.1.9. Vlerat e llojeve të pasojave
- 4.2.1.10. Vlerat e llojit të zjarrit ose shpërthimit
- 4.2.1.11. Vlerat e llojit të materialeve të rrezikshme
- 4.2.1.12. Vlerat e llojit të trafikut



1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

Ky dokument përmban standardet e specifikimeve teknike të të dhënave gjeohapësinore për ndërtimin e NSDI. Autori i këtij produkti është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik (ISHP), i cili është autoritet publik përgjegjës, për temën “*Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij*”.

Data e publikimit të versionit nr. 1 është Tetor 2019. Emërtimi i dokumentit është: ASIG_Standard_NSIDI_2019_SHNJST_v.1 ku:

ASIG – Autoriteti përgjegjës për krijimin e standardit

Standard – Lloji i dokumentit

NSDI – Qëllimi i dokumentit

2019 – Viti i krijimit

SHNJST – Tema për të cilën është krijuar standardi: “*Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij*”, e cila i referohet temës “**Human Health and Safety**” të Direktivës INSPIRE.

v.1 – Numri i versionit të standardit

2. HYRJE

2.1. QËLLIMI.

Ky dokument përcakton specifikimet teknike, për të dhënat gjeohapësinore të temës: “*Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij*”, temë e cila është përcaktuar në nenin 11, pika 2/n, të ligjit nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

Ky dokument publikohet si standard që përcakton rregullat bazë të implementimit të NSDI¹ në Shqipëri, me qëllim përdorimin e tij nga autoritetet publike përgjegjëse, për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor, që të arrihet një kuptueshmëri unike dhe korrekte e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore, për të realizuar ndërveprueshmëri midis tyre.

2.2. SI LEXOHEM DOKUMENTIN.

2.2.1. STRUKTURA E DOKUMENTIT

Ky dokument është i organizuar në katër kapituj kryesorë:

- 1- **Përshkrimi i standardeve:** – Në këtë pjesë jepet emërtimi dhe autori i standardeve.
- 2- **Hyrje:** – Në këtë pjesë jepen përshkrime dhe shpjegime për të kuptuar mënyrën si organizohet i gjithë informacioni dhe si mund të interpretohet më lehtë ai.

¹NSDI – Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Gjeohapësinor



- 3- **Tema:**- Në këtë pjesë jepen specifikimet teknike për temën “Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij”.
- 4- **Anekse:** – Në këtë pjesë jepen informacione shtesë, shpjeguese, në ndihmë të përdoruesve.

• **Përmbajtja e Kapitullit të 3-të është strukturuar në 4 pjesë kryesore:**

- 3.1. **Përshkrimi i temës** – Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e temës dhe si është e ndarë kjo temë.
- 3.2. **Përshkrimi i nëntemës së parë** – Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e nëntemës si dhe detajohen: Diagramat UML dhe Katalogu i tipologjive.
- 3.3. **Përshkrimi i nëntemës së dytë** – Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e nëntemës si dhe detajohen: Diagramat UML dhe Katalogu i tipologjive.
- 3.4. **Metadatat** – Këtu jepen specifikimet teknike për metadatat e temës përkatëse.
- 3.5. **Sistemi Koordinativ Referencë** – Këtu përcaktohet sistemi koordinativ referencë që është miratuar me vendimin nr. 669, datë 7.08.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Rregullave për Përcaktimin, Krijimin dhe Realizimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), si Metadatë” i ndryshuar me vendimin nr. 322, datë 27.4.2016 dhe vendimin nr. 359 datë 29.05.2019.
- 3.6. **Cilësia e të dhënave** – Këtu jepet një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementeve dhe matjes së tyre.

2.2.2. DIAGRAMAT UML DHE KATALOGU I TIPOLOGJIVE

Diagramat UML ofrojnë një mënyrë të shpejtë për të parë elementet kryesore të specifikimeve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Përkufizimi mbi llojin e objektit gjeohapësinor, atributet dhe marrëdhëniet janë të përfshira në ‘Katalogun i tipologjive’ (FeatureCatalogue). Personat të cilët kanë ekspertizë tematike, por nuk janë të familjarizuar me UML-në, mund ta kuptojnë plotësisht përmbajtjen e modelit të të dhënave duke u fokusuar te Katalogu i tipologjive. Për përdoruesit e aplikacioneve, Katalogu i tipologjive, mund të jetë i dobishëm për të kontrolluar nëse ai përmban të dhëna të nevojshme për përdorim.

Në tabelat e mëposhtme shpjegohet përmbajtja dhe mënyra e organizimit të informacionit, në tabelat e të dhënave, në Katalogun e tipologjive.

Tabelat nr. 1, 2, me anë të shembujve, shpjegojnë mënyrën e organizimit të informacionit, në tabelën e tipologjive dhe të attributeve të tyre.

Tabela nr. 3, me anë të një shembulli, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit, në tabelën e kodlistës.

Tabela 1

EMRI- Emërtimi i tipologjisë	
Përkufizimi	Përkufizimi për tipologjinë.
Përshkrimi	Shënime dhe përshkrime të tjera për tipologjinë.
Lloji i tipologjisë	Tipi i elementit që mund të jetë i këtyre llojeve: «FeatureType» - një element që mund të jetë real, në terren, apo një dukuri abstrakte



	<p>«DataType» - një element tabelor, që shërben vetëm si tabelë atributesh, për t' u lidhur me një element tjetër</p> <p>«Enumeration» “codeList» - listë e parapërgatitur vlerash, ku elementi duhet të marrë vlerë. <i>Enumeration</i> nënkupton “renditje vlerash”, ndërsa <i>codeList</i> nënkupton listë vlerash ose ndryshe “kodlistë”. Në dokument gjenden të shqipëruara si “Numërtimet dhe kodlistat”.</p> <p>«Union» - një mbulesë topologjike e dy ose më shumë grupeve të të dhënave gjeohapësinore, që ruan tiparet, të cilat bien brenda shtrirjes gjeohapësinore të të dy grupeve të të dhënave hyrëse.</p> <p>«Imported» - të dhëna të specifikuar në tema të tjera të Direktivës INSPIRE. Në dokument gjenden të shqipëruara si “Të dhënat e importuara”</p>
Gjeometria	<p>Gjeometria e elementit sipas formatit vektor mund të gjendet në tri forma: pikë, linjë, poligon.</p> <p>Abstrakt – kur elementi nuk është element real në terren, por konsiderohet vetëm si dukuri.</p>
Shumëllojshmëria	<p>Lloji dhe numri i vlerave që mund të marrë atributi:</p> <p>0..* - mund të marrë shumë lloje vlerash ose asnjë vlerë</p> <p>1..* - mund të marrë minimumi 1 vlerë ose shumë vlera</p> <p>0..1 - mund të mos marrë asnjë vlerë ose nëse merr vlerë, duhet të marrë vetëm 1 vlerë të vetme.</p> <p>1 - duhet të marrë detyrimisht 1 vlerë</p>
I detyrueshëm	<p>Po – nëse atributi është i detyrueshëm të plotësohet</p> <p>Jo – nëse atributi nuk është i detyrueshëm të plotësohet</p>
Rol shoqërimi	<p>Në tabelën e lidhjeve “Rol shoqërime” tregohen marrëdhëniet hierarkike ndërmjet elementeve të ndryshme në këtë temë, si dhe në temat e tjera. Këto marrëdhënie pasqyrojnë lidhjet që realizohen në skemat UML.</p>

Tabela 2

ATRIBUTET
<p>-- Emri -- Emërtimi i atributit</p>
<p>-- Përkufizimi -- Përkufizimi i elementeve</p>
<p>-- Përshkrimi --</p>



ATRIBUTET

Shënime dhe përshkrime të tjera për elementin [I detyrueshëm: Detyrueshmëria nëse atributi duhet të marrë vlerë, p.sh: PO]

Tabela 3

ATRIBUTET

<ul style="list-style-type: none"> Vlera e parë e listës së gatshme, p.sh: <i>Ligjor</i>

-- Emri --

Emërtimi i vlerës

-- Përkufizimi --

Përkufizimi i elementeve.

<ul style="list-style-type: none"> Vlera e dytë (etj.) e listës së gatshme, p.sh: <i>Joligjor</i>
--

-- Emri --

Emërtimi i vlerës

-- Përkufizimi --

Përkufizimi i elementeve.

2.2.3. KARAKTERISTIKAT <<VOIDABLE>> DHE SHUMËLLOJSHMËRIA

Stereotipi <<voidable>> përdoret për të përshkruar ato karakteristika të objekteve gjeohapësinore që mund të jenë ose mund të mos jenë të pranishme në grupet e të dhënave gjeohapësinore edhe pse mund të ekzistojnë në botën reale. Kjo nuk do të thotë që këtyre përkatësive duhet t'u jepet një vlerë.

Për të gjitha karakteristikat, e përcaktuara për objektet gjeohapësinore, duhet të paraqitet një vlerë – ose vlera përkatëse (nëse është e disponueshme në grupin e të dhënave që mirëmbahet nga ofruesi i të dhënave), ose vlera 'void'. Një vlerë 'void' nënkupton që nuk ekziston një vlerë përkatëse, në grupet e të dhënave gjeohapësinore, që mirëmbahen nga ofruesi i të dhënave ose që asnjë vlerë përkatëse nuk mund të nxirret nga vlerat ekzistuese.

Arsyeja e përdorimit të vlerës 'void' duhet të paraqitet kurdo që të jetë e mundur, duke përdorur një nga vlerat e listuara në kodlistën *VleraEArsyetSëPavlefshmërisë*(VoidReasonValue), e cila përmban:



- **E panjohur** (Unknown)

-- Përkufizimi --

Vlera korrekte për këtë element gjeohapësinor nuk njihet ose është e pamatshme nga krijuesi i të dhënave.

-- Përshkrim --

Shembull: Kur “kuota e sipërfaqes së një trupi ujor nga niveli i detit” e një liqeni të caktuar, nuk është matur, atëherë arsyeja e pavlefshmërisë së kësaj karakteristike mund të jetë “E panjohur”.

- **E papopulluar** (Unpopulated)

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë nuk është pjesë e databazës së mirëmbajtur nga krijuesi i të dhënave. Pavarësisht kësaj kjo e dhënë mund të ekzistojë.

-- Përshkrimi --

Shembull: Kur “kuota e sipërfaqes së një trupi ujor nga niveli i detit” nuk është e përfshirë në grupin e të dhënave që përmban objektin gjeohapësinor të liqenit, atëherë vlera e kësaj karakteristike mund të jetë “E pa populluar”

- **Konfidenciale** (Withheld).

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë mund të ekzistojë por është konfidenciale.

-- Përshkrimi --

Shembull: Të dhënat personale të popullsisë, të cilat ekzistojnë, por që nuk mund të shfaqen pasi mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Stereotipi <<voidable>> nuk jep asnjë informacion nëse ekziston një karakteristikë në botën reale. Kjo shprehet duke përdorur shumëllojshmërinë:

Nëse një karakteristikë mund të ekzistojë apo mund të mos ekzistojë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 0. P.sh. nëse një adresë ka apo nuk ka një numër shtëpie, shumëllojshmëria përkatëse do të jetë 0..1.

Nëse për një karakteristikë të caktuar ekziston të paktën një vlerë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 1. P.sh. nëse një njësi administrative ka gjithmonë të paktën një emër, shumëllojshmëria përkatëse do të jetë 1..*.

2.2.4. MBULIMET - COVERAGES

Funksionet e mbulimit “Coverages” përdoren për të përshkruar karakteristikat e një fenomeni të botës reale që zhvillohet në kohë dhe /ose hapësirë. Shembuj tipik të tyre janë temperaturat, lartësitë, imazheritë etj. Një mbulim përmban një grup vlerash, të cilat shoqërohen me një element gjeohapësinor, kohor, kohor - gjeohapësinor. Domeinet tipike gjeohapësinore janë grupe pikash (p.sh. vendndodhja e sensorëve), kurbat përcaktuese (p.sh. izolijnat), rrjetet (p.sh. ortoimazheria, modelet e lartësive) etj.

Në skemat e aplikimit të INSPIRE, funksionet e mbulimit janë përcaktuar si veti të llojeve të objekteve gjeohapësinore, ku lloji i vlerës së kësaj karakteristike është realizim i një prej llojeve të specifikuar në SSH EN ISO 19123.

Për të përmirësuar përputhjen me standardet e mbulimit në nivelin e zbatimit (p.sh. SSH EN ISO 19136-1 dhe OGC Shërbimi i Mbulimit në Internet) dhe për të përmirësuar harmonizimin ndërtematik, për përdorimin e mbulimeve në INSPIRE, një skemë e aplikimit për llojet e mbulimit është përfshirë në Modelin Konceptual të Përgjithshëm “GenericConceptual Model”.

Kjo skemë aplikimi përmban llojet e mëposhtme të mbulimit:

- *RrjetiMbulimitIKorrigjuar (rektifikuar)*: Mbulimi, domeini i të cilit përbëhet nga një rrjet i korrigjuar, një rrjet për të cilin ka një transformim përfundimtar midis koordinatave të rrjetit dhe koordinatave të sistemit koordinativ referencë. (shih figurën 1, majtas).
- *RrjetiMbulimitReferencë*: Mbulimi, domeini i të cilit përbëhet nga një rrjet referimi, një rrjet i lidhur me një transformim që mund të përdoret për të kthyer vlerat e koordinatave të rrjetit në vlerat e koordinatave të referuara në një sistem referimi koordinativ (shih figurën 1, djathtas).

Aty ku është e mundur përdoren vetëm këto lloje mbulimi (ose një nëntip i tyre) në skemat e aplikimit në INSPIRE.




Figura 1 – Shembuj të një rrjeti të korrigjuar (majtas) dhe një rrjeti referues (djathtas)

2.2.5. NUMËRTIME DHE KODLISTA (ENUMERATION AND CODE LIST).

Kodlistat modelohen si klasa në skemat e aplikimit, por vlerat e tyre menaxhohen jashtë skemave të aplikimit. Në kodlistën, ‘vlera të tjera’ përcaktohet lloji i përmbajtjes së kodlistës, e përcaktuar specifikisht si më poshtë:

- *‘jo’* përfaqëson kodlista që përmbajnë vetëm vlera të specifikuar në këtë dokument.
- *‘të’* kufizuara përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të specifikuar në këtë dokument dhe vlera të tjera të limituara të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.
- *‘të hapura’* përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të specifikuar në këtë dokument dhe vlera shtesë në çdo nivel, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.
- *‘po’* përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

Vlerat shtesë të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave nuk duhet të zëvendësojnë, apo të modifikojnë, vlerat ekzistuese, të përcaktuara në dokument.



Në rastin kur ofruesit e të dhënave do të përdorin kodlista me vlera “jo”, pra të specifikuar në dokument, ofruesit janë të detyruar t’i bëjnë këto vlera bashkë me përkufizimet e tyre, të disponueshme në një regjistër. Kjo do të mundësojë që edhe përdoruesit e tjerë t’i kuptojnë këto vlera dhe të kenë mundësi t’i përdorin.

2.2.6. PARAQITJA E DIMENSIONIT KOHOR

Skemat e aplikimit përdorin atributin “FillimiICiklitJetësor” dhe “PërfundimiICiklitJetësor” për të regjistruar jetëgjatësinë e një objekti gjeohapësinor.

Atributi “FillimiICiklitJetësor” specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Atributi “PërfundimiICiklitJetësor” specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në botën reale.

Ndryshimet që bëhen në atributin “PërfundimiICiklitJetësor” nuk shkaktjnë ndryshime në atributin “FillimiICiklitJetësor”.

❖ **Shënim i rëndësishëm:**

Disa terma në Katalogun e tipologjive, si p.sh. FeatureType, DataType, Void, Coveragesetj, nuk janë përkthyer qëllimisht në gjuhën shqipe. Qëllimi parësor është që të mos humbasin kuptimin gjatë përkthimit dhe së dyti të përdoret një gjuhë unike sipas termave të Direktivës INSPIRE.

2.3. DETYRIMET LIGJORE

Në bazë të nenit 16, të ligjit nr. 72/2012, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, ASIG është institucioni përgjegjës për krijimin e standardeve, për secilën nga temat e përcaktuara në nenin 11, të këtij ligji, në përputhje me standardet evropiane (Direktiva INSPIRE).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinore, për krijimin e NSDI në Shqipëri, janë përshtatur nga specifikimet teknike të temave përkatëse në Direktivën INSPIRE si dhe praktikave më të mira ndërkombëtare që mbështesin dhe bazohen në këtë direktivë. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të zbatojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore.

Standardet (Rregullat e implementimit - IR) duhet të krijohen për fushat e mëposhtme:

- **Metadata** – në këtë fushë direktiva përcakton standardet se si duhen të jenë metadatat. Ky standard është unik dhe i aplikueshëm për të gjitha institucionet ose palët e treta (sikurse është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilët do të implementojnë atë.(VKM nr. 1077, datë 23.12.2015)
- **Specifikimi i të dhënave** – standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme që do të publikohen. INSPIRE ka përcaktuar disa attribute bazë të cilat do të shërbejnë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose të nevojave të brendshme, mund të shtojnë attribute të tjera për t’i bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjitha të dhënat që do të shtohen duhet të jenë të dokumentuara dhe të miratuara nga institucionet përgjegjëse lokale.

2.4. FUSHA E VEPRIMIT

Të gjithë autoritetet publike, kompanitë private apo individë që mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinore për llogari të institucioneve publike, janë të detyruar t'i nënshtrohen këtij standardi.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga Direktiva INSPIRE ka proceset dhe ciklin jetësor, si më poshtë:




Figura 2: Proceset e ciklit jetësor

Planifikimi – Është procesi gjatë të cilit krijohen strukturat e të dhënave të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënave.

Vlerësimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do të jetë certifikimi i të dhënave ose nevoja për të modifikuar të dhënat që të përshtaten me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit.

Procesimi (Përpunimi) – Është procesi gjatë të cilit mbliidhen dhe modifikohen atributet e të dhënave për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuara gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi janë bashkësi të dhënash gati për t'u publikuar.

Shpërndarja – Është procesi gjatë të cilit të dhënat vihen në dispozicion për përdoruesit (qytetarët, autoritetet publike, organizatat ose palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, të përdorë, të analizojë ose të citojë të dhënat. Publikimi i të dhënave bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit.

Zbulimi – Është procesi i vazhdueshëm gjatë të cilit zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jociësore në të dhënat e publikuara.

Analiza – Është procesi i analizimit të të dhënave të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë këtij procesi merret vendimi çfarë do të bëhet me të dhënat që janë evidentuar.

Përditësimi – Është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënave. Ky proces regjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënave ekzistuese dhe të publikuara.

Arkivimi – Është procesi gjatë të cilit bashkësitë e të dhënave që nuk nevojiten të aksesohen arkivohen duke u bazuar në standarde kombëtare dhe në legjislacionin në fuqi të vendit ku implementohet standardi. Rezultat i këtij procesi janë të dhënat që bëhen të pa aksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen, për arsye të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose me standardet specifike.

Shkatërrimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat bëhen të parikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde kombëtare dhe në legjislacionin në fuqi.



3. TEMA

3.1. SHËNDETI I NJERËZVE DHE SIGURIA E TIJ

3.1.1. PARATHËNIE

Tema “Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij” përshkruan: Shpërndarjen gjeografike të mbizotërimit të patologjive (alergjitë, sëmundjet kanceroze, sëmundjet e frymëmarrjeve, etj.), informacionin që tregon efektet në shëndet (indikatorët biologjikë, rënia e fertilitetit, epidemitë) ose mirëqenien e njerëzve (lodhja, stresi, etj.) dhe lidhet direkt (ndotja e ajrit, kimikatet, zbrazja e shtresës së ozonit, zhurmat, etj.) ose indirekt (uji, ushqimi, organizma të modifikuar gjenetikisht, etj.) me cilësinë e mjedisit.

Komponentët e tij janë: të dhënat e shëndetit të njeriut (mbi sëmundjet, helmimet, dëmtimet, etj.) indikatorët biologjikë, të dhënat e kujdesit shëndetësor/shërbimet shëndetësore, të dhënat e matjes së përcaktuesve shëndetësor dhe ngjarjet e lidhura me sigurinë.

Përkufizimi i temës “Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij” i referohet lidhjeve të drejtpërdrejta ose të tërthorta midis patologjive dhe cilësisë së mjedisit. Modeli i të dhënave të kësaj teme paraqet të gjitha të dhënat shëndetësore, ndërsa lidhja e çështjeve specifike shëndetësore me mjedisin është pjesë e vendimit të përdoruesit.

Të dhënat statistikore në përshkrimin e temës “Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij” janë kryesisht të dhëna/indeks statistikore të shprehura në nivele të ndryshme të njësive statistikore. Sigurohet një model i përgjithshëm për të dhënat mjedisore si përcaktues shëndetësor, që ka të bëjë me të dhënat e matura të papërpunuara, me grumbullimin e këtyre të dhënave dhe me mbulimet që rezultojnë nga interpolimi i të dhënave të papërpunuara. Aspektet e sigurisë adresohen me përshkrimet e ngjarjeve që dëmtojnë njerëzit, pronat dhe mjedisin.

Tema “Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij” përmban kryesisht të dhëna që lidhen me njësitë statistikore. Këto të dhëna lidhen me shëndetin dhe indikatorët biologjikë, por nuk kanë tipologji të drejtpërdrejta gjeohapësinore, kështu që duhet të lidhen me këto tipologji duke përdorur njësitë statistikore, për shembull kodet NUTS² ose rrjetet statistikore (gridet).

Temat e mëposhtme të gjeoinformacionit janë të rëndësishme në lidhje me temën “Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij”:

- *Njësitë statistikore*: objektet gjeohapësinore të përdorura në specifikimin e të dhënave të kësaj teme janë ripërdorur.
- *Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare*: Përdorimi i objektit gjeohapësinor i përcaktuar në specifikimet e të dhënave rekomandohet për të përfaqësuar informacionin në lidhje me kujdesin shëndetësor/shërbimet shëndetësore.
- *Demografia* - tema “Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij” trajton kryesisht aspektet e kushteve shëndetësore të individëve dhe popullatave.
- *Infrastruktura industriale*
- *Infrastruktura bujqësore dhe akuakultura*
- *Pedologjia*
- *Kushtet atmosferike, meteorologjia*, për analizimin e lidhjeve të mundshme me cilësinë e mjedisit.

² NUTS – Nomenclature of Territorial Units for Statistics - Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistika



Përshkrimi:

Tema “*Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij*”, mbulon një gamë të gjerë të dhënash mbi sëmundjet dhe problemet e lidhura me shëndetin, si dhe tregues të tjerë të efekteve shëndetësore që mund të lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me cilësitë e mjedisit. Sipas këtij përkufizimi janë identifikuar disa komponentë të temës “*Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij*”, duke përfshirë:

- Të dhëna statistikore shëndetësore për sëmundjet, helmimet, dëmtimet etj., dhe të dhënat për statusin e përgjithshëm shëndetësor të një popullsie, siç janë gjendja shëndetësore e perceptuar vetë, personat me probleme shëndetësore, duhanpirësit, etj.
- Indikatorët biologjikë
- Përcaktuesit e shëndetit
- Kujdesi shëndetësor/shërbimet shëndetësore - për shembull për shërbimet e ofruara nga spitalet, forca e kujdesit shëndetësor, etj.
- Siguria.

Tema “*Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij*” trajton kryesisht aspekte të ndryshme të kushteve shëndetësore të individëve dhe popullatave; në këtë kuptim ajo ndan shumë tipologji me temën *Demografia*, si: shpërndarja gjeografike e njerëzve, duke përfshirë karakteristikat e popullsisë dhe nivelet e aktivitetit, të grumbulluara nga rrjetet (gridet), rajonet, njësitë administrative ose njësi të tjera analitike.

Disa të dhëna në përshkrimin e temës janë të dhëna/indekse statistikore, të shprehura në njësi të ndryshme gjeohapësinore. Shumica e këtyre të dhënave janë përcaktuar në bazat e të dhënave të EUROSTAT. Disa kodlista në këtë dokument rekomandohen (p.sh. *Vlera E Llojit Të Shëndetit Në Përgjithësi*). Në të përfshihen vetëm disa kodlista të EUROSTAT dhe ofruesit e të dhënave janë të lejuar t’i zgjerojnë këto kodlista.

Në raste të veçanta, të dhënat shëndetësore mund të jenë të nevojshme në shkallë të ndryshme gjeohapësinore, si të dhëna specifike të shëndetit në lidhje me shpërndarjen e popullsisë, karakteristikat në njësi të ndryshme analitike, si urbane/rurale, në aglomerate, brenda një qyteti, në lidhje me vendndodhjen e objekteve të veçanta (p.sh. industria, instalimet teknike); në zonat bregdetare apo zonat e rrezikuara nga përmytjet, etj.

Tek të dhënat statistikore shëndetësore, përdoret një kodlistë e menaxhuar nga jashtë, e emëruar *Klasifikimi Ndërkombëtar I Statistikave Të Sëmundjeve Dhe Problemeve Shëndetësore Të Ngjashme (ICD)*. *Klasifikimi Ndërkombëtar I Sëmundjeve* është standardi ndërkombëtar për të raportuar dhe karakterizuar sëmundjet, kushtet e lidhura me shëndetin dhe shkaqet e jashtme të sëmundjeve dhe dëmtimeve, të përdorura për të përftuar informacion shëndetësor (vdekshmërinë dhe gjendjen e sëmundjes) mbi vdekjet, sëmundjet dhe dëmtimet. Është klasifikimi standard diagnostik, i aplikuar për qëllime epidemiologjike, menaxhimi shëndetësor dhe përdorimi klinik.

Disa të dhëna të matshme mbi sëmundjet, dëmtimet dhe aksidentet janë në dispozicion nga burime të ndryshme. Përdoruesit e statistikave të të dhënave shëndetësore kanë të drejta në të dhënat për nivelet rajonale në bazat e të dhënave të EUROSTAT. EUROSTAT mbledh të dhëna mbi vdekshmërinë, bazuar në “Shkaqet e vdekjes” sipas gjinisë, moshës dhe rajoneve NUTS. Shkaqet e vdekjes klasifikohen në 65 shkaqet e “listës së shkurtër evropiane” të shkaqeve të vdekjes bazuar në *Klasifikimin ndërkombëtar të sëmundjeve dhe Problemet shëndetësore*.

Të dhënat e “*Shkaqeve të vdekjes*” rrjedhin nga certifikatat e vdekjes. Certifikimi mjekësor i vdekjes është një detyrim në të gjitha shtetet anëtare të OBSH-së. Të dhënat e “*Shkaqeve të vdekjes*” i referohet shkakut themelor, i cili është “sëmundja ose dëmtimi që inicion adresimin e ngjarjeve të rënda, që çojnë drejtpërdrejt



në vdekje, ose rrethanat e aksidentit, dhunës që shkaktoi dëmtimin fatal" (Organizata Botërore e Shëndetësisë). Të dhënat e ndodhjes dhe përhapjes janë në dispozicion në nivel evropian vetëm për kancerin. Burimet kombëtare dhe vendore të statistikave të të dhënave shëndetësore mund të ofrojnë më shumë të dhëna për sëmundshmërinë (p.sh ndodhjen, të dhënat e përhapjes, numri i vizitave emergjente etj.), megjithëse disponueshmëria e të dhënave mund të ndryshojë nga vendi në vend. Të dhënat për sëmundjet, dëmtimet dhe aksidentet mund të paraqiten si numra të papërpunuar, ndërsa shkalla e përhapjes, ndodhjes dhe vdekshmëria, jepen sipas gjinisë dhe moshës; për qëllime specifike (studimore), të dhënat e shëndetit mund të jepen edhe nga faktorë të tjerë (social, ekonomik, etnik, etj.).

Të dhënat e përgjithshme shëndetësore, siç janë shëndeti i vetvetes, personat me probleme shëndetësore, duhanpirësit etj., mund të paraqiten si numra të papërpunuar, shkalla, përqindja, si dhe mund të jepen sipas gjinisë, moshës apo faktorëve të tjerë social-ekonomikë (siç janë arsimi, punësimi, të ardhurat, jetesa në zonat urbane ose rurale, përcaktimi, etj.) Disa të dhëna lidhur me gjendjen e përgjithshme shëndetësore mund të kërkojnë matje (jo invazive ose invazive), në peshë, lartësi, duke u përqendruar tek disa parametra të gjakut, urinës ose në materiale të tjera biologjike. Shembuj të parametrave të tillë përfshijnë indeksin e masës trupore (BMI), përqendrimin e kolesterolit në gjak, përqendrimin e hemoglobinës në gjak, ose përqendrimin e substancave kimike të ndryshme ekzogjene në trupin e njeriut (biomarkuesit e ekspozimit). Këto të dhëna mund të shprehen si: përqendrime mesatare (mesatarja aritmetike, mesatarja, mesatarja gjeometrike dhe 95% CI), përqindje (5, 25, 90, 95%, etj.), përqindja e personave me përqendrim mbi ose poshtë vlerave "normale/të pranueshme/të lejueshme", nivelet e parametrave të testuar (poshtë limitit të zbulimit), etj.

Për indikatorët biologjikë nevojitet informacion mbi kimikatin e matur (për shembull, kadmium, merkur, cotininë) ose mbi metabolitin e tij në matricën biologjike të përdorur për të përcaktuar/cilësuar një indikator biologjik (për shembull urina, gjaku, flokët).

Kujdesi shëndetësor/shërbimet shëndetësore nuk përfshihen në modelin e të dhënave të temës "*Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij*". Për t'i përfaqësuar ato, mund të përdoret modeli i të dhënave përcaktuar nga tipologjia "*Shërbimi qeveritar (tema "Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare"*)" i cili klasifikohet në llojin e shërbimeve (Atributi "*Llojet Shërbimeve*"). *Llojet Shërbimeve* duhet të vendoset në vlerat midis atyre që ofrohen për *Kujdesin shëndetësor/shërbimet shëndetësore* (p.sh shëndeti), "*Lloji I Kuptimit*" dhe "*Lloji I Burimeve*", të cilat mund të përdoren për të ruajtur informacionin që përshkruan shërbimet (p.sh numrin e shtretërve, numrin e mjekëve).

Modeli i të dhënave për temën "*Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij*" përmban një modul për të adresuar përcaktuesit shëndetësorë mjedisorë. Ai ofron mundësinë për t'u referuar:

- Të dhënat e matshme të përcaktuesve shëndetësorë mjedisorë. Ky model bazohet në standardin SSH ISO 19103 për të dhënat e matjeve. Ky model është zgjeruar për zhurmat e lokalizuara dhe për të dhënat e përqendrimit dhe mund të zgjerohet në mënyrë të ngjashme për përcaktuesit e tjerë shëndetësorë. Kodlista *Rrjeti Europian Informacionit Mjedisor Dhe Vëzhgimit* (EIONET) rekomandohet të përshkruaj të dhënat e matura.
- Të dhënat e matshme të përcaktuesve shëndetësorë mjedisorë të agreguar përmes lidhjes me modelin e të dhënave të njësive statistikore.
- Të dhënat e mbulimit që rezultojnë nga interpolimi i të dhënave të matjeve të papërpunuara.

Në kontekstin e lidhjeve midis shëndetit të njeriut dhe cilësisë së mjedisit, kushtet më të diskutuara mjedisore përfshijnë: cilësinë e ajrit të mjedisit, cilësinë e ajrit të brendshëm dhe të jashtëm, cilësinë e ujit



(ujit të pijshëm, ujit për larje), kimikatet (nga burime të ndryshme), polenet, radonet, zhurmat dhe faktorë të tjerë fizikë.

Termi "*Siguria*" është i paqartë: pjesërisht për shkak se ajo lidhet drejtpërdrejt me shëndetin e njeriut dhe në një kontekst më të gjerë kjo do të thotë se si ndikohet mjedisi. Rritja e disponueshmërisë së të dhënave gjeohapësinore është me rëndësi të madhe si për parandalimin e emergjencave dhe për punën përgatitore, ashtu edhe për të mundësuar një përgjigje ndaj incidenteve të mëdha për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe sigurinë.

Të dhënat statistikore gjeohapësinore për aksidentet dhe incidentet përmenden në këtë dokument si "ngjarje". Kjo siguron që përshkrimi i "sigurisë" tregon si për sigurinë shoqërore dhe sigurinë e mjedisit. Përvoja përmirëson si punën parandaluese ashtu edhe gatishmërinë për trajtimin e incidenteve të paplanifikuara që dëmtojnë njerëzit, pronën dhe mjedisin. Një "ngjarje" mund të shkaktohet nga disa faktorë, por gjithnjë është e lidhur me një pikë gjeografike specifike, zonë ose pikë përgjatë një objekti gjeohapësinor linear. Modeli i të dhënave për "Sigurinë" dallon katër lloje ngjarjesh:

Ngjarje të lidhura me trafikun, ngjarje të lidhura me zjarrin ose shpërthimin, ngjarje të lidhura me rreziqet natyrore dhe ngjarje të lidhura me materialet e rrezikshme.

3.2. PËRSHKRIMI I NËNTEMËS "SHËNDETI I NJERËZVE"

3.2.1. PARATHËNIE

Katër komponentë në lidhje me "Shëndetin e njeriut" përshkruhen në një skemë aplikimi të ndarë në dy nëntema: *TëDhënatStatistikoreShëndetësore dhe DeterminantëtShëndetësorëMjedisorë*.

Nëntema e parë modelohet sipas tre diagramave që janë: "*TëDhënatStatistikoreShëndetësore-Bazë*", "*TëDhënatStatistikoreTëShëndetit-TëPërgjithshme*" dhe *TëDhënatStatistikoreShëndetësore–Kodlista/Numërtime*.

Të dhënat bazë përfshijnë një përkufizim abstrakt për *TëDhënatStatistikoreShëndetësore–Datatype* dhe të gjitha nënlojet që përshkruajnë të dhënat statistikore mbi sëmundjet, problemet shëndetësore që lidhen me to si dhe mbi treguesit e indikatorëve biologjikë (të dhëna statistikore shëndetësore dhe treguesit biokimikë).

Nëntema e dytë mbulon elementet që përshkruajnë të dhënat mjedisore që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me shëndetin e njeriut. Për këtë nëntemë nuk është realizuar një modelim të dhënash sepse përfshihen në të dhënat e temës "*Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare*" në llojin e tipologjisë *ShërbimetQeveritare-FeatureType*.




Figura 3: Diagrama UML: Nëntema “Shëndeti i njerëzve”

3.2.2. SKEMAT E APLIKIMIT DHE DIAGRAMA UML PËR NËNTEMËN “SHËNDETI I NJERËZVE”

3.2.2.1. TË DHËNAT STATISTIKORE SHËNDETËSORE, BAZË

Të dhënat që përfshihen në këtë diagramë janë të dhëna statistikore për sëmundjet, dëmtimet, etj., të dhënat për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të një popullate, për disa tipologji të shërbimeve shëndetësore, si dhe të dhëna që vijnë nga studime mbi indikatorët biologjikë, të cilat raportohen si të dhëna të grumbulluara sipas attributeve tematike, gjeohapësinore dhe kohore.

Në figurën e mëposhtme të gjitha të dhënat e këtij lloji përfaqësohen nga një tipologji abstrakte që është *TëDhënatStatistikoreShëndetësore* që ka lidhje me klasën abstrakte *NjësitëStatistikore* të skemës së aplikimit “Bazë”, dhe kështu me një nga specializimet e tij (rrjeti, auditimi urban, NUTS, rajoni, etj.) që është përcaktuar në specifikimin e të dhënave *NjësitëStatistikore*.

Informacioni statistikor mbi temën e të dhënave gjeohapësinore “*Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij*”, duhet t’i referohet objekteve gjeohapësinore siç përcaktohet në temën “*Njësitë Statistikore*”.

Informacioni i detajuar se si të modelohet një objekt gjeohapësinor që do të përdoret për të përfaqësuar të dhënat statistikore shëndetësore të njeriut mund të gjendet në specifikimet e të dhënave *NjësitëStatistikore*.




Figura 4: Diagrama UML: Të Dhënat Statistikore Shëndetësore - Bazë



3.2.2.2. TË DHËNAT STATISTIKORE SHËNDETËSORE, TË PËRGJITHSHME

Diagarama në figurën e mëposhtme përshkruan katër nën tipa të tipologjisë abstrakte të *Të Dhënave Statistikore Shëndetësore*, secila nga këto të dhëna përfaqëson një grup si: *Sëmundjet* (të dhënat statistikore shëndetësore mbi sëmundjet dhe dëmtimet), *Statistikat EPërgjithshme Shëndetësore* (gjendjen e përgjithshme shëndetësore për një popullatë), *Statistikat E Shërbimit Shëndetësor* (informacion mbi shërbimet shëndetësore, si p.sh. numri i shtretërve) dhe *Indikatorët biologjikë* (të dhëna, indikatorë biologjikë të mbledhur dhe analizuar në lloje të ndryshme studimesh). Gjithashtu kjo diagramë përfshin të dhëna të tjera, të përdorura në këtë skemë aplikimi, si dhe kodlistat dhe regjistrimet e përdorura në këtë skemë.

Sëmundjet karakterizohen nga dy attribute të detyrueshme:

- “*Barra ESëmundshmërisë*” që është një datatype që përbëhet nga dy attribute të detyrueshme: “*Llojet EBarrës Së Sëmundshmërisë*” përmban një nga indekset e kodlistës “*Vlerat ELlojit Të Barrës Së Sëmundshmërisë*” (ndodhjet, mbizotërimi, vdekshmëria dhe shpërthimi) që përdoren për të matur ndikimet e problemit të sëmundjes ose shëndetit në popullatë dhe “*vlerat*” që përmbajnë vlerën e tyre.
- “*Periudha Referencë*” e përcaktuar si periudha midis datës së fillimit dhe datës së mbarimit (*Lloji I Periudhës Referencë*) që i referohet informacionit statistikor.

Emri i sëmundjes përfaqësohet duke përdorur kodlistën e menaxhimit të jashtëm që përdoret nga komuniteti i përdoruesve të Shëndetit të Njeriut: Kodlista “*Vlerat EKlasifikimit Ndërkombëtar Të Sëmundjeve*” që tregon ICD10 - Statistika Ndërkombëtare e Klasifikimit të Sëmundjeve dhe Problemeve Shëndetësore.

Kur është e mundur, kodlista *Vlerat EKlasifikimit Ndërkombëtar Të Sëmundjeve* do të përdoret për të identifikuar emrin e sëmundjes.

Kjo klasë përfshin gjithashtu dy attribute të pavlefshme që përdoren zakonisht për të grumbulluar të dhëna: *Grup Moshat* (të dhëna të përbëra nga *Mosha E Fillimit*, dhe një varg, i tipit *Mosha*, shprehur në një nga format e mëposhtme: vite, muaj ose javë) dhe *Gjinia* (regjistrimi) në një popullatë.




Figura 5: Diagrama UML: Të dhënat statistikore shëndetësore – Të përgjithshme



Klasa *Indikatorët Biologjikë* karakterizohet nga një strukturë e ngjashme përveç “*Emrit të Indikatorit biologjik*” që përkufizohet nga dy pjesë informacioni, nga ajo kimike dhe matrica (të dyja të përcaktuara si kodues të zbrazët, të shtrirë për çdo shtet), dhe disa parametra të zakonshëm statistikorë (*Llojet e Parametrave Statistikorë të Indikatorëve Biologjikë*) që përdoren për të përshkruar vlerën e indikatorit biologjik dhe janë të domosdoshme për të krahasuar rezultatet nga studime të ndryshme.

Gjithashtu klasa *Statistikat e Përgjithshme Shëndetësore* ka një strukturë të ngjashme, e cila karakterizohet nga një vlerë që i referohet një parametri (*Emri i Shëndetit të Përgjithshëm*), i listuar në kodifikuesin *Vlerat e Llojit të Shëndetit të Përgjithshëm*, që përdoret nga çdo shtet.

Si përfundim, *Statistikat e Shërbimit Shëndetësor* karakterizohen nga një *Periudhë Referuese* dhe nga një *Vlera të Shërbimit* që i referohet një parametri specifik, midis atyre të listuara në kodlistën *Vlerat e Llojit të Shërbimit Shëndetësor*.

Kjo kodlistë përfshin disa artikuj dhe përkufizime të marra nga “Kujdesi shëndetësor: burimet dhe pacientët” të përdorura nga EUROSTAT,

(http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_SDDS/EN/hlth_care_esms.htm). Kjo kodlistë nuk është shteruese dhe mund të jetë e zgjeruar në shtete të ndryshme.



Figura 6: Diagrama UML : Të dhënat statistikore shëndetësore – Kodlistat



3.2.2.3. DIAGRAMA E PËRCAKTUESIT SHËNDETËSOR MJEDISOR

Të dhënat e përcaktuesit shëndetësor janë përgjegjëse për:

- Të dhënat e matjeve të papërpunuara të vendosura diku.
- Grumbullimi statistikor i këtyre të dhënave të matjes së papërpunuar raportohet në disa njësi statistikore.
- Mbulimet që rrjedhin nga një ndërhyrje e këtyre të dhënave të matjes së papërpunuar.

Me qëllim konceptimin më të qartë të kësaj databaze më poshtë jepen disa shembuj për mbledhjen e të dhënave.

Shembull: Përqendrimi i nitrarit në ujërat e liqenit, përqendrimi i polenit në ajrin e ambientit, zhurma nga trafiku rrugor.

